



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada - Government

Ministria e Shëndetësisë - Ministarstvo zdravstva - Ministry of Health
Divizioni i Prokurimit/Divizia Nabavke/Procurement Division

Prishtine datë, 17.07.2025

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Ministrisë së Shëndetësisë, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 63 të Rregullores për Prokurim Publik të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës **11.07.2025**, të parashtruar nga **Gani B. Krasniqi B.I. D.P.Z "Suzuki"** lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **"Servisimi i automjeteve të MSH-se"** me nr. prokurimi 206-25-4944-2-2-1, nxjerr:

V E N D I M

1. **Pranohet**, si e bazuar kërkesa për ri-shqyrtim e OE Gani B. Krasniqi B.I. D.P.Z "Suzuki" e dt. 11.07.2025, lidhur me aktivitetin e prokurimit **"Servisimi i automjeteve të MSH-se"** me nr. prokurimi 206-25-4944-2-2-1, kundër Njoftimit për kontratë të datës 27.06.2025;
2. **Korrigjohet**, Njoftimi për kontratë të datës 27.06.2025;
3. Autoriteti Kontraktues, do të procedoj me Njoftimin për Korrigjim B54;
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

A r s y e t i m

OE **Gani B. Krasniqi B.I. D.P.Z "Suzuki"** me datën 11.07.2025, ka parashtruar kërkesë për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **"Servisimi i automjeteve të MSH-se"** me nr. prokurimi 206-25-4944-2-2-1. Autoriteti Kontraktues sot me datë 17.07.2025 e ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga AK sipas OE ankues:

Ligjit nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092 si në vazhdim:

- Neni 1, i LPP-së Qëllimi;
- Neni 7, i LPP-së Barazia në Trajtim/ Jo- Diskriminimi;

- Neni 27, i LPP-së Dosja e Tenderit;
- Neni 28, i LPP-së Neni 28 Specifikimet teknike;
- Neni 69, i LPP-së Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale;

Dispozitat e Rregullores Nr. 001/2022 Për Prokurim Publik në tekstin e mëtejshëm do të i referohemi RRPP-së

- Neni 17, i Rregullores Nr. 001/2022 Për Prokurim Publik; Dosja e Tenderit;
- Neni 25, i Rregullores Nr. 001/2022 Për Prokurim Publik; Kriteret e përzgjedhjes.

Pretendimet ankimore të OE ankues:

Me datën 27.06.2025 Autoriteti Kontraktues Ministrin e Shëndetësisë përmes Platformën eprokurimi <https://e-prokurimi.rks-gov.net/>. ka bërë publike Njoftimin për Kontratë për aktivitetin e prokurimit me Titull: "Servisimi i automjeteve të MSH-se", me nr të prokurimit: 206-25-4944-2-2-1. Në këtë aktivitet të prokurimit ju si AK-ja keni përpiluar Dosjen e Tenderit në kundërshtim me Ligjin për Prokurim Publik, duke favorizuar një OE.

Ne kemi analizuar dosjen e tenderit dhe pas analizës që kemi bërë, kemi vërejtur se DT-ja është në kundërshtim me LPP-në, për faktin se janë vendosur kërkesa diskriminuese/favorizuese, të cilat do të sqarojmë më poshtë. Pretendimet tona janë si më poshtë:

Autoriteti Kontraktues ndër të tjera ka kërkuar si në vijim:

Pretendimin ankimor nr. 1:

Ne njoftimin për Kontratë dhe DT, të Kapaciteti mbi mundësitë teknik dhe profesional, respektivisht neni 9.1 & 9.2, të kërkesa me Nr.3 është kërkuar *Operatori Ekonomik duhet të posedoj mjetet, stabilimentet dhe pajisjet teknike që janë të domosdoshme për realizimin e kontratës.* për pikat;

- d. Pajisje për diagnostikimin e automjeteve për Mercedes benz C4 plus origjinal
 - dh. Diagnoza BMW ISTA+
 - e. Pajisje diagnoza origjinale për Peugeot (DIAGBOX)
 - ë. Pajisje diagnostifikime për WV, Shkoda, Audi, Seat -Odis (VNCI 6154 A)
- Për këto pajisje, pika d.dhe.e.ë, Ju si AK ka vendosur kritere diskriminuese, ku për këto pika, nevojitet vetëm një Pajisje kompjuterike për diagnostifikimin e defekteve të automjeteve.
- Kërkesa e AK-së se OE-ja duhet të posedoj pajisje *d. Pajisje për diagnostikimin e automjeteve për Mercedes benz C4 plus origjinal, dh. Diagnoza BMW ISTA+, e. Pajisje diagnoza origjinale për Peugeot (DIAGBOX), ë. Pajisje diagnostifikime për WV, Shkoda, Audi, Seat -Odis (VNCI 6154 A).* Janë të panevojshme dhe absurde, pasi absolutisht nuk ka nevojë për këto pajisje të tilla. Të gjitha këto pajisje për pikat d, dh,e,ë që AK-ja i ka kërkuar në Njoftimin për Kontratë dhe DT, mund të kryejnë me vetëm një pajisje e cila quhet **Pajisje kompjuterike për diagnostifikimin e defekteve të automjeteve.** Me një pajisje speciale mund të kryhen të gjitha shërbimet në të gjitha llojet e automjeteve. Pa pasur nevojë të përcaktohet lloji i pajisjes me emër përkatës dhe me kode. Ku pajisja speciale e bënë identifikimin e të gjitha llojeve të automjeteve.

- Kërkesa me Nr.3 e pajisjve për pikat d.dhe.e.ë, është favorizuse për OE te caktuar. Pasi që AK-ja në NJF,dhe DT, ka kërkuar pajisje me emra te prodhuesve, me specifikate qe i pershtaten vetem një OE-se, si psh; **C4 plus origjinal, BMW ISTA+,(DIAGBOX), Odis (VNCI 6154 A)**, ku për këtë shërbime kërkohet vetem një pajisje. Në këtë raste AK-ja nuk ka siguruar një procet te mirëfilltë te prokurimit.
- Kërkesa me Nr.3 e pajisjve për pikat d.dhe.e.ë, Nga cilido këndvështrim që të analizojm, kërkesat për këto pika janë kërkesa diskriminuse. Autoriteti Kontraktues e ka perpiluar Dosjen e tenderit në kundërshtim me Nenin 7 te LPP-së. Po ashtu kjo kërkesë është ne kundërshtime te plote me nenin 69 te LPP-së.
- Është kërkesa Nr. 3 e vendosur diskriminuse, pika d.dhe.e.ë, dhe është e dukshme se është përcaktuar që në fillimi fitusi i këtij tenderit.Për arsye se janë kërkuar pajisje te pa nevojshme, ku këtë shërbim e kryen vetem me një pajisje.
- Kërkesat me Nr.3 për pikat d.dhe.e.ë, nuk janë në përputhje te plote edhe me Aneksin 1, Specifikacionin teknik lista e çmimeve. AK-ja ka pershkruar të gjitha automjetet, tipin, vitin, dhe sasin e automjeteve. Ka kërkuar një pajisje; *d. Pajisje për diagnostikimin e automjeteve për Mercedes benz C4 plus origjinal*, AK-ja posedon vetem një automjet te tipit Mercedes 180 C 2.0, (Benzin) 2002, 1998 cm3 **1 veturë**. AK-ja për automjetin Mercedes 180 C, Benzin i vititi te prodhimit 2002,ka kërkuar pajisje origjinale per diagnostifikim, automjete i cili nuk është i pajisur me pajisje per identifikimin e defekteve, se është i vitit te prodhimit 2002.
- Te lista e çmimeve AK-ja ka ne posedime edhe automjetin Opel Mevano 2021 2.3 dizel. Për këtë automjete i vitit te prodhimit 2021, te teklogjise se fundit nuk ka kerkuar fare Pajisje për diagnostikimin e automjeteve për Opel origjinale, siq ka bërë për automjetet tjera.
- AK-ja ka kërkuar pajisje për diagnoz origjinale BMW ISTA+, AK-ja posedon vetem një automjet te tipit BMW e vitit te prodhimit 2015. Pajisja ISTA+, e kërkuar nga AK-ja është për automjetet e BMW, e vitit te prodhimit 2023-2025, automjeti i AK-së është vititi te prodhimit 2015. Këtë shërbime të diagnozes e kryen edhe me Pajisje kompjuterike për diagnostifikimin e defekteve të automjeteve.
- Paisje diagnoz origjinale per Peugeot (DIAGBOX) e kërkuar nga AK-ja ne NJF, DT, në specifikacionin teknik lista e çmimeve, rezultone se AK-ja posedon vetem kater automjete te tipit Peugeot. Këtë shërbime të diagnozes e kryen edhe me Pajisje kompjuterike për diagnostifikimin e defekteve të automjeteve.
- Paisje diagnostifikime per WV, Shkoda, Audi, Seat -Odis (VNCI 6154 A) e kërkuar nga AK-ja ne NJF, DT, në specifikacionin teknik lista e çmimeve, rezultone se AK-ja posedon gjashtë automjetet te tipit Audi, dhe Shkoda Autoriteti kontraktues kërkon pajisje diagnostifikuse për Seta Odis, pa e poseduar as edhe një automjete te vetem te këti llojit.
- Gjithashtu AK-ja te specifikacionin teknik lista e çmimeve i posedon automjete si;

Suzuki Grand Vitara 2.4 Benzin, 2012, 2 vetura	Suzuki SX4 1.6 Benzin 4X4, 2012, 7 Vetura	Nisan Pathfinder 2009 2.5 Dizel 1 Veturë	Suzuki Wagon 2001/2004 1.3 Benzin 2 Vetura	Opel Mevano 2021 2.3 dizel 1 Veturë
--	---	--	--	-------------------------------------

Për këto automjete AK-ja, të cilate i ka shumicë, qe i cekum me larte nuk kërkon fare pajisje për diagnostifikme, duke e specifikuar kodin, emrin e pajisjes. Ndersa për automjete te cilat i posedon nga një copë, edhe nuk posedon fare hiq ka kërkuar pajisje diagnoz orginale.

- Kërkesat me Nr.3 për pikat d.dhe.e.ë, janë kërkesa diskriminuese dhe jo transparente. Këto kërkesa janë në kundërshtime me nenin 7,27,28 të LPP-së. Nga Themelimi i AK-së, MSH-së, në historikun e sajë për të njëjtin aktivitet të prokurimit gjithmone është kërkuar vetëm Pajisje për diagnostifikimin e defekteve të automjeteve. Po ashtu edhe në aktivitetin e fundit për lamin e njeje te prokurimit në Njoftimin për Kontrat dhe Dosjen e tenderit ka kërkuar;

Prove, siq është ka qene kërkesa;

c. Paisje per diagnostifikimin e automjeteve minimum 1 copë.

Në kuptime të Nenit 7,27 dhe 28 të LPP-së, dhe duke u bazuar në Dispozitat e Rregullores Nr. 001/2022 Për Prokurim Publik, Neni 17 dhe 25, përmes B54 Formulari standard për korrigjimin e gabimeve në njoftimet e publikuara, AK-ja të bëjë korrigjimin e DT-së, për pikat d.dhe.e.ë. Ngase këto pajisje nuk përkojnë me natyrën dhe qëllimin e këtij aktiviteti të prokurimit, sepse si AK- ne as një rastë nuk e kemi kërkuar pajisje të tilla.

Bazuar në faktet e lartë cekura konsiderojmë se këto kërkesa nuk janë në harmoni me LPP-në dhe qëllimin e këtij tenderi. Posedimin i pajisjeve d.dhe.e.ë, të përmendura më lartë të korrigjohen nga dosja e tenderit sepse vetëm kufizon konkurrencën në mënyrë të paarsyeshme.

Pretendimin ankimor nr. 2:

Sa i përket kërkesës në Njoftimin për kontratë, të Kapaciteti teknik dhe profesional, respektivisht neni 9.1 & 9.2, në DT, është kërkuar të Kërkesa me Nr 6.Operatori Ekonomik duhet të ketë në pronësi ose në marrëveshje me qira një servis funksional për automjete, i cili ndodhet jo më larg se 5 km nga objekti i Ministrisë së Shëndetësisë.

- Kërkesa e AK-së që servisi mos të jete ndodhet jo më larg se 5 km nga objekti i Ministrisë së Shëndetësisë. Nuk është në përputhje të plot me LPP-në. AK-ja MSH-ja në kuader të këtij aktiviteti të prokurimit me titull: "Servisimi i automjeteve të MSH-se" ka përfshirë edhe Departamente tjera të cilat janë në kuader të Ministrisë së Shëndetësisë si;
- **Departamenti i Sistemit të Informacioneve Shëndetësore, Departamenti Ligjore, Departamenti për Intergrime Evropiane dhe koordinim të Politikave, Departamenti Shëndetësor i Burgjeve, Departamenti për zhvillim Strategjik Shëndetësorë, Departamenti për Administratë dhe Shërbime të Përgjithshme, Departamenti për Cilësi, Siguri, Licencim dhe Akreditim të Institucioneve Shëndetësore, Departamenti për Buxhete dhe Finaanca, dhe Instituti Special Shtime.**
- Nga Objektiti i AK-së Ministria e shëndetësisë, me adres Rr. Zagrebi, Prishtina, deri te Instituti Special Shtime, është me një largësi 30 km.
- Nga Objektiti i MSH-së Rruga Zagrebi deri të Departamenti Shëndetësor i Burgjeve është një largësi prej 3.1 km, e DEPARTAMENTA TJERA, të cilat janë me sliqje në qytetin e Prishtinës.
- Kërkesa me Nr.6 është diskriminuese për faktin se AK-ja MSH-ja në qytetin e Prishtinës dhe në territorin e Republikës së Kosovës posedon edhe Departamente tjera, shumica e automjeteve i perkasin ketyre Instituteve, dhe departamenteve. Po ashtu Autoriteti kontraktues MSH-ja, posedon edhe sliqje tjera, me vendndodhje në qytetin e Prishtinës.
- Si ka mundësi që AK-ja me këto departamente në kuader të saj, me vendndodhje në qytetin e Prishtinës, Në njoftimin për Kontratë dhe Dosjen e Tenderit vendos kriter që largësi e servisit-objektiti të me se largu 5 km nga MSH-ja, duke u thirrur vetëm nga një pike referuese.
- Andaj në kuptim të LPP-së dhe Rregullores Nr. 001/2022 të korigjohet DT-ja, dhe largësia e lokacionit të objektiti mos të jetë më shumë se 10 km nga Qyteti i Prishtinës, se në qytetin e Prishtinës AK-ja posedon departamente me sliqje, vendndodhje me lokacione të ndryshme të AK-së. Është jashtë logjikës dhe totalisht apsurde që AK-ja të vendos kriter se OE duhet të ketë servis të vetin apo të marrjes me qera me se largu 5 km nga Objekti i MSH. AK-ja thirret vetëm në një pike referuese.
- Kërkesa me Nr.6 që OE duhet të ketë servis të vetin apo të marrjes me qera me se largu 5 km nga Objekti i MSH. Kriteri kufizues prej 5 km nga objekti i AK-së, është kërkesë që ua mbyllin mundësinë e ofertimit të gjithëve bizneseve që mirren me servisim dhe mirëmbajtje të automjeteve. Në qytetin e Prishtinës janë vetëm dy kompanitë të cilat marrin pjesë në aktivitetet të prokurimit të natyrës së njëjtë për servisim dhe mirëmbajtjes së automjeteve. Bizneset tjera të cilat gjindene në Regjionin e Prishtinës. Si bizneset Rr. Prishtinë-Podujev, Rr. Prishtinë-Fushë Kosovë km2, Rr. Magjistrallja Prishtinë-Lipjan, km. i 5-të. Prishtinë-Graçanic, etj, e kanë të pamundur të marrin pjesë në këto aktivitetet të prokurimit. Bizneset të cilat marrin pjesë në aktivitetet të prokurimit të natyrës së servisimit mirëmbajtjes së automjeteve cilat gjindën në këto lokacione, në regjione të Prishtinës e kanë të pamundur të marrin pjesë për shkak të kriterit të caktuar në NJF dhe DT, të kërkesës Nr.6, të kufizimit të km-ve. Ku

thua se të shumica e këtyre biznesev i zhvillojnë veprimtarit në këto adresa. Me kriterin e vendosur në DT, te kërkesa me nr.6 nuk mundësohet pjesëmarrje e gjerë e Operatorve ekonomik, por në këtë mënyrë është kufizuar tej mase konkurrenca.

- As një here ne as një Autoritet në Republikën e Kosovës nuk e ka përcaktuar një kërkesë te tillë të natyres se njejt te prokurimit për servisime dhe mirëmbajtje te automjeteve. Ne këtë raste as vete ju si AK qe jeni.

Autoriteti tjera ne Republikën e Kosovës as njera nuk e vendos kriterin kufizus prej 5,km.

Prova nr.1

- Autoriteti Kontraktues Ministria e Mjedisit Planifikimi Hapësinor dhe Infrastrukturës me datën 02.07.2024 ka publikuar aktivitetin e prokurimit me Titull: Servisimi dhe mirëmbajtja te Kia Sportage;Jepp MX Compass; Ford Kuga; Land Rover Freelander; Ford Mondeo; Nissan X Tryal; Toyota Prada;Wv Polo Ww Bora ,Nisan Pathfinder, me nr prokurimit: 205-24- 6446-2-2-1, në NJF dhe DT, te Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale 9.1 & 9.2, Kërkesa me nr.3 është kërkuar që, dëshmi si më poshtë;

3.Largësia e auto servisit mos te jetë me e madhe se 15 km nga Qyteti i Prishtinës.	3.Largësia e auto servisit mos te jetë me e madhe se 15 km nga Qyteti i Prishtinës.
--	--

Prova nr.2

- Autoriteti Kontraktues Shërbimi Korrektues i Kosovës me datën 08.11.2023 ka publikuar aktivitetin e prokurimit me Titull: Servisimi dhe mirëmbajtja e automjeteve të MD-se dhe Njësive të saj, me nr i prokurimit: 33600-23-12447-2-1-1 në NJF dhe DT, te Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale 9.1 & 9.2, Kërkesa me nr.2 është kërkuar që, dëshmi si më poshtë;

2. Hapësira e objekt-ve (servisa-ve) duhet të jetë e mbyllur dhe e mbrojtur nga ndikimet e faktorëve të jashtëm, siç janë reshjet, era, pluhuri, dhe me largësi jo më shumë se 10 km nga Qyteti i Prishtinës, e tërë hapësira duhet të jetë nën vëzhgimin e kamerave për monitorimin ku servisohen automjetet, (kërkohet për pjesën 1, pjesën 2, pjesën 3).	2. Hapësira e objekt-ve (servisa-ve), të dëshmohet me fotografi, dhe dokumentacion përkatës zyrtar për pronësi. Nëse objekti- punëtorja është marre me qira si dëshmi kërkohet kopja e kontratës e noterizuar se qirasë. Konfirmimin se tërë hapësira e objekt-ve (servisa-ve) është nën vëzhgimin e kamerave për monitorimin ku servisohen automjetet dhe parkingu.
---	--

Prova nr.3

- Autoriteti Kontraktues Ministria e Punëve të Jashtme me datën 25.06.2024 ka publikuar aktivitetin e prokurimit me Titull: Mirëmbajtja dhe servisimi i automjeteve të MPJD, me nr i prokurimit: 216-24-6421-2-2-1, në NJF dhe DT, te Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale 9.1 & 9.2, Kërkesa me nr.1 është kërkuar që, dëshmi si më poshtë;

Kapaciteti teknik dhe profesional: OE duhet te kete hapsiren e e objektit te (servisit-ve)min. 200 m2. Kjo hapsire duhet te jete e mbyllur dhe e mbrojtur nga ndikimet e faktoreve te jashtem, siq jane reshjet , era ,pluhuri etj, dhe jo me larg se 15 km nga ndertesa qendrore e MPJD-se, rr.Luan Hradinaj pn, Prishtine	Dëshmia e kërkuar dokumentare Hapsira e objektit duhet te dëshmohet me dokumentacion perkates zyrtar per pronesi ose kontrata per marrje me qira per te cilen duhet te dëshmoj me dokumentacion perkates zyrtar per pronesi nga qiradhenesi. Duhet te dëshmoj hapesiren e kerkuar me dokumentacionin i cili posedon hapsiren ne baze te metrave te kerkuar dhe largesin nga objekti i MPJD-se.
--	---

Prova nr.4

- Autoriteti Kontraktues MINE BUJOËSISË, PYLLTARISË DHE ZHVILL. RURAL me datën 27.05.2025 ka publikuar aktivitetin e prokurimit me Titull: Mirëmbajtja dhe servisimi i automjeteve për nevojat e MBPZHR-së me nr i prokurimit: 203-25-4685-2-2-1, në NJF dhe DT, te Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale 9.1 & 9.2, Kërkesa me nr.1 është kërkuar që, dëshmi si më poshtë;

Kapaciteti teknik dhe profesional: Kërkesa 1 Operatori Ekonomik duhet që të ketë Objektin – Punëtorinë për servisimin dhe mirëmbajtjen e automjeteve jo më larg se 15 Kilometra nga Selia e Ministrisë së Bujqesis, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural në Prishtinë, bazuar në rrugën më të afërt tokësore të asfaltuar. Shënim: Të drejte ofertimi kanë të gjithë Operatorët Ekonomik, pa marrë parasysh se në cilin vend apo lokalitet kanë selinë e regjistrimit të kompanisë por bazuar në parimin e efikasitetit dhe ekonomikitetit, Operatorët Ekonomik që ofertojnë duhet që Objektin – Punëtorinë për servisimin dhe mirëmbajtjen e automjeteve që kanë në pronësi apo të marrur me qira, ta kenë jo më larg se 15 Kilometra nga Selia e Ministrisë së Bujqesis, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural në Prishtinë, bazuar në rrugën më të afërt tokësore të asfaltuar.	Dëshmia e kërkuar dokumentare Dëshmitë për kërkesën nr.1 Nëse Objekti- punëtoria është në pronësi si dëshmi kërkohen kopjet e dokumentacionit të pronësisë. Nëse objekti- punëtoria është marrë me qira si dëshmi kërkohet kopja e kontratës së qirasë.
--	---

Prova nr.5

- Autoriteti Kontraktues Agjencia Qendrore e Prokurimit me datën 01.03.2024 ka publikuar aktivitetin e prokurimit me Titull: Servisimi dhe mirëmbajtja e automjeteve për nevojat e Agjencive të Pavarura, me nr i prokurimit: UA/2016-24-1513-2-2-1, në NJF dhe DT, te Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale 9.1 & 9.2, Kërkesa me nr.1 është kërkuar që, dëshmi si më poshtë;

Go to

Kapaciteti teknik dhe profesionale: Kërkesa 1 Operatori Ekonomik duhet që të ketë Objektin – Punëtorinë për servisimin dhe mirëmbajtjen e automjeteve jo më larg se 15 Kilometra nga Ndërtesa e Agjencisë Qendrore të Prokurimit në Prishtinë, bazuar në rrugën më të afërt tokësore të asfaltuar. Shënim: Të drejte ofertimi kanë të gjithë Operatorët Ekonomik, pa marrë parasysh se në cilin vend apo lokalitet kanë selinë e regjistrimit të kompanisë por bazuar në parimin e efikasitetit dhe ekonomicitetit, Operatorët Ekonomik që ofertojnë duhet që Objektin – Punëtorinë për servisimin dhe mirëmbajtjen e automjeteve që kanë në pronësi apo të marrur me qira, ta kenë jo më larg se 15 Kilometra nga Ndërtesa e Agjencisë Qendrore të Prokurimit në Prishtinë, bazuar në rrugën më të afërt tokësore të asfaltuar.	<i>Dëshmia e kërkuar dokumentare</i> Dëshmitë për kërkesën nr.1 Nëse Objekti- punësia është në pronësi si dëshmi kërkohen kopjet e dokumentacionit të pronësisë. Nëse objekti- punësia është marrë me qira si dëshmi kërkohet kopja e kontratës së qirasë.
--	---

Prova nr.6

- Autoriteti Kontraktues Agjencia Kosovare e Privatizimit me datën 04.07.2024 ka publikuar aktivitetin e prokurimit me Titull: Mirëmbajtja dhe servisimi i automjeteve të AKP-së, me nr i prokurimit: 239-24-6573-2-2-1, në NJF dhe DT, te Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale 9.1 & 9.2, Kërkesa me nr.9 është kërkuar që, dëshmi si më poshtë:

9.Largësia e lokacionit të servisit të mos jetë më shumë se 15 km nga zyrat e AKP-së Selia Qendrore	9.Duhet të ofroj një deklaratë ku shpjegon adresën e saktë të kompanisë ose të kenë marrëveshje me ndonjë kontraktues për këto shërbime në distancën e kërkuar.
--	--

Prova nr.7

- Autoriteti Kontraktues Kuvendi i Komunës së Prishtinës me datën 21.03.2023 ka publikuar aktivitetin e prokurimit me Titull: Servisimi dhe mirëmbajtja e automjeteve të KPSH-se, me nr i prokurimit: 616-23-2421-2-1-1, në NJF dhe

DT, te Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale 9.1 & 9.2, Kërkesa me nr.9 është kërkuar që, dëshmi si më poshtë;

5. OE duhet te ket servis te vetin apo te marrjes me qera me se largu 10 km nga Prishtina.	. OE duhet te ofroj deklarate me shkrim per vendin e ndodhjes per objektin e servisimit te automjeteve. Ne raste te marrjes se objektit me qera OE duhet ta kete marrveshjen e marrjes me qera te objektit.
--	---

Prova nr.8

- Autoriteti Kontraktues Agjencia Kosovare për Krahxim dhe Verifikim të Pronës, me datën: 11.05.2023 ka publikuar aktivitetin e prokurimit me Titull: Servisimi i Rregullte dhe Mirëmbajtja me Pjese Rezerve per 33 Veturat e AKKVP-se, me nr i prokurimit: 329-23-4392-2-2-1, në NJF dhe DT, te Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale 9.1 & 9.2, Kërkesa me nr.16 është kërkuar që, dëshmi si më poshtë;

Kerkesa 16. SHËNIM ME RËNDËSI! Largësia e AUTOSERVISIT!	Deshmua 16. Konsideruar nenin 6 të LPP-se e qe ka te beje me Ekonomizimin dhe Efikasitetin e procesit te prokurimit, atehere AK i AKKVP-se pa qellime diskriminimi ndaj OE pjesemarres ne proces si dhe duke respektuar nenin 7 te LPP-se ne lidhje me Barazine ne trajtim dhe Jodiskrimin,ka vendosur si më poshtë -Operatori Ekonomik fitues i mundshëm i kontratës për Servisimin dhe Mirëmbajtjen e Veturave të AKKVP-së; largësia e të cilit ndodhet më shumë se 15Km nga baza kryesore e AKKVP-së (Rr.'Perandori Justinian', nr.71, Prishtinë), obligohet ta bëjë transportin e veturave të AKKVP-së nga baza kryesore e saj dhe deri te autoservisi i Operatorit Ekonomik si dhe anasjlltas, per servisimin dhe mirëmbajtjen e veturave me Shpenzimet e Operatorit Ekonomik pra të fituesit të kontratës!. -Operatori
--	---

	Ekonomik, duhet të plotësoj një deklaratë ku tregon shpjegon adresën e saktë të vendodhjes së kompanisë! -Autoriteti Kontraktues me konkretisht komisioni vlerësues ruan të drejtën që ta bëjë matjen e distancës, si dhe të bëjë verifikim të çdo lloji informacioni ose dokumenti të dorëzuar ofruar nga ana e OE pjesëmarrës në këtë proces të prokurimit!
--	--

Prova nr.9

- Autoriteti Kontraktues Administrata Tatimore e Kosovës me datën: 21.05.2025 ka publikuar aktivitetin e prokurimit me Titull: Servisimi dhe mirëmbajtja e veturave zyrtare sipas kërkesave të AK-së (tenderi është i ndarë në 4 pjesë), me nr i prokurimit: 11600-25-4483-211, në NJF dhe DT, të Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale 9.1 & 9.2, Kërkesa me nr.3 është kërkuar që, dëshmi si më poshtë:

Kërkesa 3: Hapësira e objektit të servisit kërkohej të jetë minimum 250 m² me dokumentacion përkatës zyrtar për pronësi ose kontrata për marrje me qira për të cilën duhet të dëshmoj me dokumentacion përkatës zyrtar për pronësi nga qiradhënësi. Kjo hapësirë duhet të jetë e mbyllur dhe e mbrojtur nga ndikimet e faktorëve të jashtëm, siç janë: reshjet, era, pluhuri. Hapësira e objektit të servisit, duhet të jetë larg në rrugë tokësore maksimumi deri 15 kilometra me pikë referimi nga ndërtesa e Objektit të AK-së me adresë: Bulevardi: Dëshmorët e Kombit & Bill Clinton, Prishtinë. (kërkohej për pjesën 1, pjesën 2, pjesën 3, pjesën 4).

Prova nr.10

- Autoriteti Kontraktues Ministria e Punëve të Brendshme me datën: 18.06.2025 ka publikuar aktivitetin e prokurimit me Titull: "Servisimi dhe mirëmbajtja e automjeteve të MPB-së" me nr i prokurimit: 214-25-5471-2-2-1, në NJF dhe DT, të Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale 9.1 & 9.2, Kërkesa me nr.a është kërkuar që, dëshmi si më poshtë;

Kapaciteti teknik dhe profesional: a. Operatorët Ekonomik pjesëmarrës duhet që të kenë Objektin – Punëtorinë për servisimin dhe mirëmbajtjen e automjeteve minimum me sipërfaqe prej 200 m², i cili ndodhet jo më larg se 15 Kilometra nga ndërtesa qendrore e MPB-së, Rr Luan Haradinaj pn, Prishtinë, bazuar në rrugën me të afërt tokësore të asfaltuar. Kjo hapësirë duhet të jetë e mbyllur dhe e mbrojtur nga ndikimet e faktorëve të jashtëm, siç janë reshjet, era, pluhuri, etj.	<i>Dëshmia e kërkuar dokumentare</i> a. Hapësira e objektit-ve (servisit-ve) të dëshmohet me dokumentacion përkatës zyrtar për pronësi ose kontrata për marrje me qira për të cilën duhet të dëshmoj me dokumentacion përkatës zyrtar për pronësi nga qiradhënësi. Duhet të dëshmoj hapësirën e kërkuar me dokumentacionin i cili posedon hapësirën në baze të metrave të kërkuar dhe largësinë nga objekti i MPB-së.
---	---

- Duke u mbështeture te provat e lartë cekura, në lidhje me largësin e objektit servisit, ku themi të gjitha Institucionet në Republikën e Kosovës, te cilatë iniciojne procedura te natyrës se njetë për servisim dhe mirëmbajtje te automjeteve, as njëra nuk e kufizojn me kriterin 5 km nga objekti i AK-së.

- Me këto kërkesa, te cekura në NJF dhe DT, kërkesa me Nr.3, pika d.dhe.e.ë, me kërkesën me Nr.6, kufizimi jo me larg se 5 km nga një pike referuse, jo që nuk mund të ketë trajtim të barabartë të operatorëve ekonomik por do të ketë diskriminim të hapur dhe përcaktim të fituesit qysh në start të këtij aktiviteti të prokurimit, pa konkurrencë të hapur.

- Në raste se nuk korigjohen këto kërkesa nga ana e AK-së që tani dihet fitusi i këtij tenderi dhe pastaj mundësia e dëmtimit të buxhetiti, pasi që kompania që i plotsone këto kërkesa normalishte që ofertone me çmime te larta dhe jo ne harmoni me çmimet e tregut.

- Me këto kërkesa, te cekura në NJF dhe DT, Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale 9.1 & 9.2 kërkesa me Nr.3, pika d.dhe.e.ë, me kërkesën me Nr.6, kufizimi jo me larg se 5 km nga një pike referuse janë në kundërshtime te plote me nenin 7 te LPP-së paragrafi 6 Gjatë udhëheqjes së aktiviteteve të prokurimit, të gjitha autoritetet kontraktuese do të sigurojnë; (i) pjesëmarrjen sa më të gjerë të mundshme të operatorëve të interesuar ekonomik lidhur me çmimin dhe lëndën e prokurimit; (ii) publikimin e rregullt, dërgimin dhe/ose disponueshmërinë e të gjitha njoftimeve, ftesave, informacioneve dhe dokumenteve që kanë të bëjnë me aktivitetin e prokurimit në përputhje me këtë ligj; (iii) 19 eliminimin e praktikave, kriterëve, kërkesave dhe specifikimeve teknike që diskriminojnë në favor ose kundër një ose më shumë operatorëve ekonomik; (iv) që të gjitha specifikimet teknike dhe të gjitha kërkesat për përzgjedhje dhe dhënie, duke përfshirë rëndësinë relative të secilës kërkesë dhe kriter të tillë, si dhe metodat e përzgjedhjes dhe dhënies të saktësohen në njoftimin e kontratës ose konkursit përkatës të projektimit, në ftesën për tender ose pjesëmarrje dhe/ose në dosjen e tenderit; (v) që asnjë kërkesë, kriter, specifikim që nuk është saktësuar kështu, të mos përdoret në procesin e përzgjedhjes ose dhënies, dhe (vi) që tenderi i zgjedhur të përputhet

me të gjitha aspektet përmbajtjesore të kushteve, kritereve dhe specifikimeve përkatëse.

- Me kërkesat e vendosura nga ana e AK-së të cilat i cekum me lartë nuk mundësohet pjesëmarrje e gjerë e operatorëve ekonomik, por në këtë mënyrë është kufizuar tej mase konkurrenca dhe këto kërkesa janë drejtpërdrejtë kufizuese, konkurrenca me kërkesa të pa nevojshme atëherë edhe çmimi ofertues i operatorëve ekonomik të favorizuar automatikisht është shumë më i lartë sepse nuk kanë konkurrencë dhe faktikisht determinohet çmimi nga ana e autoritetit kontraktues në bazë të kërkesave të dosjes së tenderit.
- Duke u bazuar në dëshmitë argumentet dhe provat të cilat i cekum me lartë rezultojnë se dosja e tenderit nuk është përpiluar në harmoni me nenin 27 të LPP-së dhe njëkohësisht nuk janë marr parasysh as neni 17.17 i Rregullores nr.001/2022 për Prokurim Publik ku shkruan qartë që *“Dosja e tenderit do të përgatitet në mënyrë që nuk: Kufizon konkurrencën në mesin e OE-ve, ose Diskriminon kundër ose vepron në favor të një ose më shumë OE-ve”*.
- Kërkesat që u kundërshtuan më lartë, janë favorizuese/diskriminuese dhe njëkohësisht ua mbyllin dyert e ofertimit shumë kompanive me eksperiencë në këtë fushë dhe gjithashtu këto kërkesa bien në kundërshtim edhe me nenin 25.4 të Rregullores nr.001/2022 për Prokurim Publik, ku shkruan qartë se *“Gjatë përcaktimit të kërkesave minimale për kualifikim, AK do të kushtoj rëndësi të veçantë zhvillimit të OE dhe do të formuloj kërkesat minimale të kualifikimit në mënyrë që nuk përjashton OE të themeluar rishtazi të cilët posedojnë aftësi të arsyeshme dhe të njaftueshme ekonomike, financiare dhe/ose teknike”*.
- Bazuar në të gjitha këto të gjetura me lartë të përshkruara për këtë aktivitet të prokurimit, këto kërkesa janë diskriminuese për shumë OE. favorizuese për një OE të caktuar, rezultojnë se këto kërkesa bien në kundërshtim me nenin 1 të LPP-së- qëllimi ku citohet the shkruan qartë: *Qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën më efektive, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.*

4. Dëmet materiale

Dëmet materiale janë të konsiderueshme, mose marrja pjesë në këtë aktivitet të prokurimit, dhe dëmtimi i buxhetit të RKS.

Përgjigjet e Autoritetit Kontraktues ne lidhje me pretendimet ankimore:

E kemi shqyrtuar kërkesën tuaj për rishqyrtim dhe mund të konstatojmë se pretendimet e juaja ankimore është pjesërisht i bazuar dhe si i tillë merret parasysh nga AK për korrigjim.

Pranohet Pretendimi juaj ankimor nr. 1

Korrigjohet kërkesa nr. 3 e DT, të Kapaciteti mbi mundësitë teknik dhe profesional 9.1 & 9.2,

Ne vend të kërkesave:

- d. Pajisje për diagnostikimin e automjeteve për Mercedes benz C4 plus origjinal
dh. Diagnoza BMW ISTA+
- e. Pajisje diagnoza origjinale për Peugeot (DIAGBOX)
- ë. Pajisje diagnostifikime për VW, Shkoda, Audi, Seat -Odis (VNCI 6154 A)

Kerkohet nje pajisje me pershkrimin: **Pajisje speciale kompjuterike për diagnostifikimin e defekteve të automjeteve.**

Pranohet Pretendimi juaj ankimor nr. 2

Korrigjohet kërkesa nr. 6 e DT, të Kapaciteti mbi mundësitë teknik dhe profesional 9.1 & 9.2, në vend të distancës 5 km, kërkesa e AK-së do të jetë që **servisi të jete jo më larg se 10 km nga objekti i Ministrisë së Shëndetësisë**. Reference për ne është objekti I MSh ku janë të koncentruara shumica e dermuese e veturave dhe të gjitha Departamentet e përmendura nga ana juaj në ankese, gjenden në objektin e MSh-se, përveq ISSH në Shtime dhe DSHB në Lakrishtë-Prishtinë.

Si përfundim ne i kemi aprovuar dy pretendimet e juaja, duke i zbutur kriteret e tenderit, meqenëse qëllimi ynë si AK-MSh nuk është diskriminimi i asnjë OE, por në kuadër të tregut të lirë të arrijmë të një kontratë kualitative për shërbimet e kërkuara, andaj edhe kufizimi i distancës së servisit nga ana e AK është i nevojshëm, meqenëse gjatë implementimit të kontratës përveç shpenzimeve të levizjes së automjeteve deri të servisi i OE është edhe aspekti i kohës së zyrtareve dhe komisioneve të AK që u duhet për të shkuar deri në servis.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar në ato që u thanë më lart ka vendosur si në dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. **Ankesa pranë OSHP-se duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjetë) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.**



Berat Marmullaku

Zyrtari përgjegjës i Prokurimit